



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3181/22 prot.

Datë 14.02.2024

V E N D I M

Nr. 183/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 113/2024, datë 30.01.2024, për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-91613-12-19-2023, me objekt: “Blerje Kimikate për nevojat e Ukt.Sh.A”, me fond limit 209,959,375 lekë pa TVSH, me Nr. REF-91621-12-19-2023, me objekt: “Loti 3: ‘Blerje Poliklorur Alumini 10±0.5 %’”, me fond limit 76,560,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 22.01.2024 nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjetllës Kanalizime Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6., Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Tiranë.
Adresa: Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133,
Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 30.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 113/2024, ku vendosi:
[...]

1. *Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91613-12-19-2023, me objekt: “Blerje Kimikate për nevojat e Ukt.Sh.A”, me fond limit 209,959,375 lekë pa TVSH, me Nr. REF-91621-12-19-2023, me objekt: “Loti 3: ‘Blerje Poliklorur Alumini 10±0.5 %’”, me fond limit 76,560,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 22.01.2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjetllës Kanalizime Tiranë.*
2. *Të pranoje pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.*
3. *Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.*
4. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
5. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK.*
6. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
7. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. prot., datë, (dërguar në adresën e emailit të KPP-së), protokolluar me tonën nr.3182/19 prot., datë 14 .02.2024 me objekt “Informacion mbi zbatimin e vendimit...”, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 113/2024 , datë 30.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91613-12-19-2023, me objekt: “Blerje Kimikate për nevojat e Ukt.Sh.A”, me fond limit 209,959,375 lekë pa TVSH, me Nr. REF-91621-12-19-2023, me objekt: “Loti 3: ‘Blerje Poliklorur Alumini 10±0.5 %’”, me fond limit 76,560,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 22.01.2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjetllës Kanalizime Tiranë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. prot., datë, (dërguar në adresën e emailit të KPP-së), protokolluar me tonën nr.3182/19 prot., datë 14 .02.2024 me objekt “Informacion mbi zbatimin e vendimit...”, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin 113/2024 , datë 30.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91613-12-19-2023, me objekt: “Blerje Kimikate për nevojat e Ukt.Sh.A”, me fond limit 209,959,375 lekë pa TVSH, me Nr. REF-91621-12-19-2023, me objekt: “Loti 3: ‘Blerje Poliklorur Alumini 10±0.5 %’”, me fond limit 76,560,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 22.01.2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjetllës Kanalizime Tiranë.

II.2.Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike konstatohet, se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, e cila është në përputhje me vendimin nr.113/2024, datë 30.01.2024 të këtij Komisioni.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin nr. 113/2024, datë 30.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi pasi ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) shtojcën me ndryshimet në dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e vendimit 113/2024, datë 30.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-91613-12-19-2023, me objekt: “Blerje Kimikate për nevojat e Ukt.Sh.A”, me fond limit 209,959,375 lekë pa TVSH, me Nr. REF-91621-12-19-2023, me objekt: “Loti 3: ‘Blerje Poliklorur Alumini 10±0.5 %’”, me fond limit 76,560,000 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 22.01.2024, nga autoriteti kontraktor, SH.A Ujësjetllës Kanalizime Tiranë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

